

## Konkluzionet e Konferencës dhe Rekomandimet

Konkluzionet dhe rekomandimet nga konferenca rajonale *"Roli i parlamenteve në nxitjen e investimeve dhe konkurrencën në Ballkanin Perëndimor"* janë të grupuara në 3 fusha kryesore.

### A. Roli i parlamenteve

### B. Rekomandime për rrjetin

**C. Kapaciteti i parlamenteve për të zhvilluar mbikëqyrjen e politikave të ndihmës shtetërore, konkurrencës dhe tërheqjen e investimeve.**

**A. Parlamentet kanë tri role kyçe në promovimin e investimeve dhe konkurrencës në Ballkanin Perëndimor:**

- 1 . Krijimi i zgjidhjeve legislative për promovim dhe tërheqje të investimeve dhe përmirësimin e aftësive konkurruese
- 2 . Monitorimi i zbatimit të politikave për nxitjen dhe tërheqjen e investimeve dhe përmirësimin e aftësive konkurruese
- 3 . Sigurimi i një buxheti për aktivitete për tërheqje të investimeve dhe përmirësimin e aftësive konkurruese

### B. Rekomandimet e Rrjetit të Komisioneve Parlamentare

- 1 . Rrjeti njih rëndësinë e politikave për tërheqjen e investimeve dhe rolin e parlamenteve në promovimin e investimeve dhe konkurrencën në Ballkanin Perëndimor.
- 2 . Parlamentet inkurajohen që të angazhojnë biznes komunitetin, odat e tregtisë, shoqatat e punëdhënësve, investitorët, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë joqeveritar në mbikëqyrjen e politikave për ndihmë shtetërore, konkurrencë dhe investimeve të huaja direkte.
- 3 . Rrjeti inkurajon parlamentet që të angazhohen në diskutime mbi zhvillimin e strategjive rajonale për zhvillim ekonomik, të cilat do të zhvillohen nga institucionet dhe iniciativat përkatëse rajonale.
- 4 . Rrjeti inkurajon zhvillimin e analizave të kostos së legjislacionit në rajonin e Ballkanin Perëndimor që ndihmon në përmirësimin e përgjithshëm të biznes mjedisit.
- 5 . Rrjeti rekomandon zhvillimin e analizës mbi ndikimin e politikave të ndihmës shtetërore në Ballkanin Perëndimor dhe shpërndajnë atë me komisionet që janë pjesë të Rrjetit.

### **C. Zhvillimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të parlamenteve:**

1 . Rrjeti inkurajon parlamentet të shpërndajnë dhe miratojnë praktikat më të mira për mbikëqyrjen e politikave të ndihmës shtetërore dhe tërheqjen e investimeve të huaja direkte.

2 . Rrjeti inkurajon parlamentet dhe komisionet parlamentare që të zhvillojnë një kulturë mbikëqyrëse të seancave të rregullta vjetore të mbikëqyrjes mbi zbatimin e ndihmës shtetërore dhe politikave të IHD-ve .

3 . Rrjeti duhet të zhvillon më shumë trajnime dhe të përkrah zhvillimin e personelit parlamentar për t'i pajisur ata me njohuritë dhe mjetet e nevojshme për mbështetje të deputetëve në mbikëqyrjen e politikave të ndihmës shtetërore, investimeve dhe konkurrencës .